

## **STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "EmpoMidas" SH.P.K**

- Mexhit Cuka, lindur në Tiranë më 13.05.2001, me numër personal K205130251

Palët e mësipërme kanë vendosur të nënshkruajnë statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky statut.

### **NENI 1 – FORMA**

1.1 Shoqëria "EmpoMidas" Sh.P.K krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij statuti.

1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

1.3 Statuti i shoqërisë është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet të cilat nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

### **NENI 2 – EMËRTIMI**

Emërtimi i shoqërisë është "EmpoMidas" Sh.P.K.

### **NENI 3 – OBJEKTI I SHOQËRISË.**

3.1 Shoqëria do të merret me dhënien e shërbimeve të marketingut.

3.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë sipas nenit 3.1 të statudit

### **NENI 4 – SELIA**

4.1 Selia e shoqërisë është në Tiranë, rruga Shyqyri Ishmi, pallati 79/1, sh 1, kati 3, apartamenti 8.

4.2 Transferimi i selisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

4.3 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e degëve, filialeve dhe përfaqësive të shoqërisë në qytete të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

### **NENI 5 – KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË**

5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

5.2 Shoqëria mund të priset para këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### **NENI 6 – KAPITALI THEMELTAR**

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1 000 000 lekë.

6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga nje kuote, të gjitha të nënshkruara, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë, përcaktuar në nenin 7 të këtij statuti.

#### **NENI 7 – KONTRIBUTET**

7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- Personi Mexhit Cuka ka depozituar një vlerë prej 1 000 000 lekësh

7.2 Sipas kontributeve të mësipërme :

- Personit Mexhit Cuka i përket një kuotë me vlerë nominale 1 000 000 lekë që korrespondon me 100% të kapitalit të shoqërisë.

#### **NENI 8 – RRRITJA E KAPITALIT THEMELTAR**

8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar prej tyre.

#### **NENI 9 – ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR**

9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e lejuar nga ligji.

9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar prej tyre.

#### **NENI 10 – TRANSFERIMI I KUOTAVE**

10.1 Kuotat janë lehtësisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërbllim apo pa shpërbllim, në kuptimin më të gjerë të fjales, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të disa subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë ti ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.

10.3 Në një rast të tillë, ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet ti referohet të gjithë kuotës së ofruar për shitje.

10.4 Ortakët do të kenë kohë 15 ditë nga marrja e letrës rekomande, për ti komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, presupozohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ofruar nga ortaku që transferon atë, do të ndahet mes ortakëve pranues, në përpjesëtim të drejtë me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të cilën ato zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund tu transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendim pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.

10.7 Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie, ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund tu transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve me shumicë të thjeshtë.

10.8 Në rast se në prej ortakëve dëshiron ti dhurojë kuotat e tij tek njëri prej ortakëve të tjerë apo tek një palë e tretë jashtë shoqërisë, është plotësisht i lejuar të bëjë diçka të tillë.

#### **NENI 11 – ASAMBLEJA E ORTAKËVE DHE KOMPETENCAT E SAJ**

11.1 Organi vendim-marrës i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese : ndryshimi i statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave (perjashtim bën rasti kur një nga ortakët dëshiron ti dhurojë kuotat e tij; në këtë rast ai mund ta bëjë diçka të tillë pa miratimin e Asamblesë së Ortakëve), shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky statut apo legjislacioni përkatës.

11.3 Nëse një institucion financiar bëhet pjesë e Asamblesë së Ortakëve, institucioni nuk ka të drejtë vendimmarrjeje apo pjesëmarrjeje në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve.

#### **NENI 12 – E DREJTA E PJESËMARRJES DHE E VOTËS**

12.1 Çdo ortak (përveç një institucioni financiar) ka të drejtë të marrë pjesë në asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota në proporcion me vlerën nominale të kuotës së kapitalit që ai zotëron.

12.2 Çdo ortak ka të drejtën të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.

12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

#### **NENI 13 – THIRRJA E ASAMBLESE SË ORTAKËVE, KUORUMI, DHE VENDIMET**



13.1 Asambleja e ortakëve thirret të paktën një herë në vit brenda 120 ditëve kalendarike nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të administratorit, ekspertit kontabël dhe inventarit.

13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet tu dërgohet ortakëve dhe ekspertit kontabël të paktën 7 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë.

13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së shoqërisë.

13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet me thirrjen e parë për shkak të mungesës së kuorumit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij statuti, Asambleja do të thirret brenda 30 ditëve me të njëjtin rend dite.

13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës ose videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëtarët të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rendin e ditës. Pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe sekretari i mbledhjes.

13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm të tërë ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.

13.7 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve për të cilat kërkohet një shumë e thjeshtë votash, janë të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm të gjithë ortakët me të drejtë vote. Në mënyrë që vendimi i Asamblesë së Ortakëve të quhet i vlefshëm, duhet miratimi i tij nga ortakë, vlera nominale totale e përbashkët e të cilëve është 51% ose më shumë.

13.8 Asambleja e Ortakëve vendos ndryshimet në statut, zmadhimet ose zvogëlimet e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro te ortakëve, vlera nominale totale e përbashkët e të cilëve është 51% ose më shumë.

13.9 Çdo asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një sekretar i cili mund të jetë edhe jo-ortak.

13.10 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga kryetari i Asamblesë dhe sekretari.

#### **NENI 14 – ADMINISTRIMI**

14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën një administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje për një periudhë prej 5 vitesh. Administratori do të emërohet nga Asambleja me shumicë votash, ku për çdo 10% të kapitalit themeltar që një ortak zotëron, ka të drejtën e një vote, dhe administratori zgjidhet me shumicë votash.

14.2 Përfaqësimi ligjor i shoqërisë i besohet administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat konform me sa parashikohet në nenin 95 të ligjit nr 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", përveç sa parashikohet në nenin 14.3 në vijim.

14.2 Përfaqësimi ligjor i shoqërisë i besohet administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat konform me sa parashikohet në nenin 95 të ligjit nr 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", përveç sa parashikohet në nenin 14.3 në vijim.

14.3 Do të jetë i nevojshëm autorizimi paraprak i ortakëve, me vendim që do të merret me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 70% të kapitalit të shoqërisë, për përmbushjen e akteve në vijim.

- Marrja e kredive, garancive, çeljen e linjave të kredive në përgjithësi pranë çdo institucioni financiar apo ndërmarrje kredie, lidhjen e kontratave me objekt operacione financiare dhe/ose ekonomike, operacione ekonomike dhe/ose financiare të çdo lloji tjetër, blerje ose shërbime me apo pa garanci, me një vlerë më të madhe se 15 000 euro ose vlerë të njëjtë në monedhë tjetër.
- Shitblerja, nënshkrimi i kontributeve dhe dhënia me qira e ndërmarrjes ose degëve të ndërmarrjes.
- Hapja e degëve të reja të ndërmarrjes.
- Themelimi i shoqërive të çdo tipi, i bashkimit të shoqërive dhe enteve kolektive të çdo tipi.
- Blerja dhe shitja e pjesëmarrjeve apo interesave të çdo lloji.
- Blerja, shitja apo dhënia me qera e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të regjistruara.

14.4 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

14.5 Asambleja e Ortakëve emëron si administrator të shoqërisë: Mexhit Cuka me nr personal K205130251. Afati i emërimit është 5 vjet nga dita e regjistrimit në QKR, me të drejtë ripërtëritjeje. Administratori ka të drejtën e dorëheqjes nga detyra e tij kurdo që ai e shikon të arsyeshme. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, administratori mund të shkarkohet përpara perfundimit të mandatit të tij.

14.5 Asambleja e Ortakëve mund të emërojë më shumë se një administrator të shoqërisë, me një shumicë votash.

14.6 Administratori i përgjithshëm përfaqëson shoqërinë tregtare në marrdhënie me të tretet. Vetëm ai mund të autorizojë njërin prej administratorëve të tjerë për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.

#### **NENI 15 – EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR**

15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve apo librave kontabël të shoqërisë, mund të besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.

15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet në çdo kohë sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

#### **NENI 16 – VITI FINANCIAR DHE BILANCI VJETOR**

16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.

16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 120 ditëve që nga fundi i vitit financiar.

#### **NENI 17 – FITIMET**

17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcionin e kuotave që zotërojnë.

17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera, apo edhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

#### **NENI 18 – PRISHJA**

18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve me shumicën e kërkuar për ndryshimet në Statut.

18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

#### **NENI 19 – LIKUIDIMI**

19.1 Në rast prishje, shoqëria duhet të likuidohet.

19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose disa likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare për gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit të ortakëve, në proporcion me vlerën nominale të kuotës së zotëruar prej tyre në kapitalin themeltar.

#### **NENI 20 – ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve të shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

20.2 Nëse mosmarrëveshja nuk arrihet të zgjidhet në mënyrë miqësore, atëherë vendimi përfundimtar merret nga ortaku që zotëron minimumi 69% të kapitalit themeltar.

Tiranë më 07/06/2020

ORTAKËT

MEXHIT CUKA



---